

VENDIM
Nr.71, datë 9.8.2011

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË SHQYRTIMIT TË APLIKIMIT TË
SHOQËRISË “DITEKO” SHPK PËR KUALIFIKIMIN E IMPIANTIT PRODHUES PËR
“HEC-ET NË LUMIN ZALLI I OKSHTUNIT”: HEC-ET “BOROVË”, “ZABZUN”,
“SEBISHT”, “PRODAN 1”, “PRODAN 2”, “OKSHTUN EKOLOGJIK”, “TERNOVË”,
“OKSHTUN”, “LUBALESH 1”, “LUBALESH 2” DHE “GJORICË” SI BURIM I
RINOVUESHEM ENERGJIE

Në mbështetje të neneve 8, pika 2 germa “ll”, 9 dhe 39 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 18 pika 1 germa “d”, të “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, të miratuara me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.21 datë 18.3.2009, dhe neneve 6, 7 pikat 1 e 2 dhe nenit 8 të “Rregullave dhe procedurave të certifikimit të prodhimit të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme”, të miratuara me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.9, datë 21.2.2007, Bordi i Komisionerëve, në mbledhjen e tij të datës 9.8.2011, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Diteko” sh.p.k. për kualifikimin e impiantit prodhues për hec-et: “Borovë”, “Zabzun”, “Sebisht”, “Prodan 1”, “Prodan 2”, “Okshtun Ekologjik”, “Ternovë”, “Okshtun”, “Lubalesh 1”, “Lubalesh 2” dhe “Gjoricë” si burim i rinovueshëm energjie,

konstatoi se:

Aplikimi i paraqitur nga shoqëria “Diteko” sh.p.k. është konform rregullave dhe procedurave të certifikimit të prodhimit të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme, si më poshtë:

- Neni 7, pika 1, germa “a”, “b”, “c”, “d”

Përshkrimi i përgjithshëm i centralit.

Ky dokumentacion është dhënë i saktë dhe i plotë.

- Neni 7, pika 2, germa “a”, “b”, “c”, “d”

Dokumentacioni vijues grafik, planimetria e përgjithshme, skema funksionale etj.

Ky dokumentacion është paraqitur në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “Diteko” sh.p.k. për kualifikimin e impiantit prodhues për hec-et: “Borovë”, “Zabzun”, “Sebisht”, “Prodan 1”, “Prodan 2”, “Okshtun ekologjik”, “Ternovë”, “Okshtun”, “Lubalesh 1”, “Lubalesh 2” dhe “Gjoricë” si burim i rinovueshëm energjie.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin lidhur me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani